



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjimore 2016 – 2020

Bashkia Vlorë

Viti 2018

Tabela e Përmbajtjes

GJETJET KRYESORE	4
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË VLORË	6
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2018.....	8
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	8
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	12
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	24
REKOMANDIME.....	24

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh në kuadrin të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë’, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të **Komisionit Evropian**. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standartet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2018.

Gjetjet Kryesore

- Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 303 raste të dhunës në familje të raportuara në Drejtorinë e Policisë Vlorë.
- Janë paraqitur pranë gjykatës 221 kërkesa për urdhëra mbrojtje të reja, prej të cilave 13 kërkesa për Urdhëra Mbrojtje dhe 208 kërkesa për Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje. Këtyre kërkesave gjykata u është përgjigjur me lëshimin e 159 urdhërave sipas neneve përkatëse, 33 të pushuar dhe 26 janë rrëzuar.
- Në të gjithë Qarkun e Vlorës janë plotësuar 242 Kërkesë Padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje për 242 raste. Ndër këto raste, 4 prej tyre kanë qenë të përsëritura.
- Bashkia Vlorë ka organizuar 16 aktivitete ndërgjegjësuere në bashkëpunim me OSHCT-të operuese në këtë bashki.
- Drejtoria Vendore e Policisë, Qendra Vatra, Bashkia Vlorë, Prefektura e Qarkut Vlorë, Shërbimi Social Rajonal, Drejtoria e Shëndetit Publik, Qendra Aulona dhe Qendra Rinore Rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë në 2018 kanë organizuar 4 seanca informuese mbi temën “*Dhuna me bazë gjinore. Shkaqet dhe Pasojat. Raportimi dhe institucionet përgjegjëse*”.
- Bashkia Vlorë nuk ka akoma një bashkëpunim apo/dhe koordinim me organizata me bazë fetare.
- Gjatë muajit mars 2018 midis Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në bashkinë Vlorë dhe Policisë u vendos një marrëveshje bashkëpunimi në funksion të mirë-manaxhimit dhe zgjidhjes së rasteve
- Përgjatë vitit 2018 MRR në Bashkinë Vlorë ka realizuar dy mbledhje të Komitetit Drejtues dhe 12 të Grupit Teknik.
- Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2018, Mekanizmi i Referimit ka trajtuar 11 raste viktime të dhunës në familje.
- Gjatë periudhës janar – dhjetor 2018, asnjë rast viktimë dhune nuk është mbështetur me bonuse sociale, pavarësisht lobimit të organizatave jo-qeveritare në Vlorë. Aplikimi për bonuse sociale qëndron hapur në periudha të caktuara kohore. Kjo bën që skema të mos jetë fleksibël dhe të mos përputhet me dinamikën e rasteve që paraqesin nevoja për strehim emergjent. Përveç kësaj, aplikimi në skemën e

bonuseve sociale kërkon një numër të madh dokumentash, ka kosto financiare dhe kërkon kohë fizike për plotësimin e dosjes.

- Nuk janë zhvilluar trajnime të përbashkëta me anëtarët e MRR. Trajnimi i fundit është zhvilluar gjatë vitit 2014
- Nuk është alokuar në buxhetin e bashkisë së Vlorës asnjë mundësi financiare për të mbështetur materiale promovuese. Materialet promovuese (broshura, fletë-palosje, banera) janë prodhuar dhe shpërndarë nga organizata të shoqërisë civile, në kuadër të programeve dhe projekteve që ata ndjekin dhe implementojnë.
- Bashkia Vlorë nuk ka një zë specifik në buxhet dedikuar mirëfunksionimit dhe veprimtarisë së MKR.
- Gjatë vitit 2018, koordinatori ka referuar 10 raste pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit. Gjithashtu, edhe Qendra Vatra ka referuar për punësim dhe regjistrim në kurse të formimit profesional pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional 24 vajza dhe gra viktime të dhunës në familje.
- Bashkëpunimi me Zyrën e Përmbarimit dhe bashkisë Vlorë mungon totalisht. Nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi/shkëmbim informacioni. Nuk janë trajtuar/manaxhuar raste që kanë pasur nevojë për ndërhyrjen e zyrës së përmbarimit. Nuk kanë qenë prezent në asnjë takim, situatë kjo e njëjtë me një vit më parë
- Shërbimi i Provës është institucion i cili nuk përfaqësohet asnjëherë në mbledhjet e GTN. Përveç kësaj mungon edhe komunikimi midis koordinatorit dhe kësaj strukture (koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për t'u trajtuar me programe të tilla). Gjithashtu koordinatori nuk ka informacion mbi format e aplikuara të shërbimeve apo kohëzgjatjen e shërbimit.
- Bashkia Vlorë vazhdon të paraqesë të njëjtat nevoja emergjente për manaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës: mungesa e banesave sociale për strehim dhe akomodim të rasteve viktime të dhunës; të mos pasurit e një zëri specifik buxheti për mirëfunksionimin e MRR; mungesa e një mjeti transporti në manaxhimin e bashkisë për transportin fizik të viktimave të dhunës në qendra të specializuara.
- Në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” dhe Drejtorinë Vendore të Policisë, gjatë vitit 2018 është ndërmjetësuar dhe realizuar akomodimi i 4 rasteve gra viktime të dhunës në familje dhe 7 fëmijëve të tyre pranë Strehëzës Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje në Tiranë. Komunikimi me këtë institucion kërkuar shpesh ndërmjetësimin e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” dhe Shërbimit Social Shtetëror për akomodimin e rasteve pranë kësaj qendre rezidenciale.
- Ka një sërë shërbimesh që mungojnë në bashkinë Vlorë, por një ndër më kryesorët mbetet rehabilitimi i dhunuesve përmes programeve të specializuara. Mungesa e linjës së këshillimit/qendër rehabilitimi për dhunuesit burra; qendër e specializuar shërbimesh për viktimat e dhunës në familje me probleme të shëndetit mendor që paraqesin nevoja urgjente për strehim. Bashkia Vlorë nuk ofron shërbime

këshillimi për djemtë dhe burrat dhunues. Në territorin e Bashkisë nuk operojnë organizata të specializuara që ndjekin programe rehabilituese për dhunuesit. E vetmja strukturë që ofron shërbime këshillimi për djemtë dhe burrat dhunues është Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Vlorë

Sipas të dhënave të përfituara nga bashkia e Vlorës, gjatë vitit 2018 janë regjistruar 227 raste të dhunës të raportuara. Krahasuar me vitin 2017 është e dukshme diferenca sa i përket vendbanimit të viktimës me 75 % të rasteve brenda në qytet dhe 25 % në zonat rurale. Në të njëjtat statistika qëndron edhe variabli “gjini”. Niveli arsimor i viktimës gjendet kryesisht në kategorinë e arsimit 9-vjeçar dhe arsimit të mesëm. Gjatë vitit 2017 është vënë re se asnjë person me arsim të lartë nuk ka raportuar raste të dhunës në familje, por e kundërta ndodh përgjatë vitit 2018 ku 20% e rasteve të dhunës në familje rezultojnë të jenë me arsim të lartë.

Gjithashtu, vihet re se mbi 50% e rasteve janë persona të cilët nuk janë në marrëdhënie pune. Më shumë se 50% e rasteve të raportuara për këtë periudhë, marrëdhënia ndërmjet viktimës dhe dhunuesit ka qenë bashkëshortore, ndërkohë që pjesa më e vogël raportojnë dhunë nga fëmijët. Po ashtu, shumica dërrmuese janë paraqitur në institucionin përkatës për të raportuar dhunën në familje për herë të parë.

Çdo muaj Drejtoria Vendore e Policisë ka organizuar takime në *Komisariatën e Policisë Vlorë* mbi trajtimin e problematikave të rasteve viktime dhunës. Takimet janë zhvilluar me pjesëmarrjen dhe kontributin e përfaqësuesve nga Bashkia Vlorë, Prefektura e Qarkut dhe Vatra. Çështje të diskutuara gjatë takimeve: referimi i rasteve viktime të dhunës dhe rëndësia e kësaj çështje; nevoja për ofrimin e shërbimeve direkte; ekzekutimi i UM dhe UMM dhe ekzekutimi i pensionit ushqimor për fëmijët, etj.

Në bazë të statistikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë për vitin 2018, sa i përket urdhërave të mbrojtjes, janë paraqitur pranë kësaj gjykate 221 kërkesa për urdhëra mbrojtje, prej të cilave 13 kërkesa për Urdhëra Mbrojtje dhe 208 kërkesa për Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje. Këtyre kërkesave gjykata u është përgjigjur me lëshimin e 159 urdhërave sipas neneve përkatëse, 33 të pushuar dhe 26 janë rrëzuar. Nga numri total i kërkesave janë përfunduar 218 të tilla dhe kanë mbetur pa përfunduar 3 prej tyre. Pranë gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur për ankim 7 raste për urdhër të menjëhershëm mbrojtje.

Duhet theksuar se ka pothuajse një shpërndarje të barabartë të kërkesave të reja për urdhër mbrojtje në 6-mujorin e parë dhe 6-mujorin e dytë të vitit 2018, specifikisht 105 kërkesa në 6-mujorin e parë dhe 116 kërkesa në 6-mujorin e dytë.

Sipas të dhënave statistikore nga Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë për dhunën në familje gjatë vitit 2018, vihet se janë trajtuar pranë këtij institucioni 224 raste viktime të dhunës në familje, prej të cilëve 193 vajza dhe gra dhe 31 djem dhe burra.

Është grupmosha 26 – 35 vjeç e cila ka edhe numrin më të lartë të viktimave të dhunës në familje, specifikisht 108 raste, ndjekur nga grupmosha 36 – 45 vjeç me 8 raste. Në 151 rastet e viktimave të dhunës në familje pranë bashkisë Vlorë, autori ishte bashkëshorti/ja.

Lidhur me shpeshësinë e paraqitjes së rasteve në këtë institucion, vihet re nga 224 prej tyre, 176 raste janë paraqitur për herë të parë (*nuk kanë marrë asnjeherë shërbime prej gjykatës në fjalë*) dhe 48 raste janë paraqitur pranë institucionit 2 ose më shumë herë, jo domosdoshërisht për çështje të dhunës në familje.

Duke krahasuar statistikat e vitit 2017, referuar vetëm Komisaritit të Policisë Vlorë, nuk ka diferencë të ndjeshme në numrin e rasteve të raportuara (*222 raste në vitin 2017*). Ndërkohë, nëqoftëse i referohemi Drejtorisë Vendore të Qarkut Vlorë, rastet e raportuara për dhunën në marrëdhëniet familjare në të gjithë Qarkun Vlorë kanë pësuar rritje në masën 20%. Kjo rritje shpjegohet si tregues i sensibilizimit të komunitetit për raportimin e dhunës.

Në të gjithë Qarkun e Vlorës janë plotësuar 195 Kërkesë Padi për Urdhër të Mbrojtje. Ndër këto raste, 4 prej tyre kanë qenë të përsëritura.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Qarkut Vlorë

Dhuna në familje	Bashkia Vlorë	Burra	Gra
Raste të evidentuara	303	245	55
Vrasje raste/viktima	1/2	0	0
Viktima			
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	195		
Shkelje Urdhër Mbrojtje	15		
Vepër penale- Neni 130/a	52	0	38
Autorë të arrestuar	21	19	0
Autorë të ndaluar	1	15	0
Autorë të shpallur në kërkim	3	3	0
Autorë në gjendje të lire	36	36	0
Autorë të vetvlarë	0	0	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Vlorë, në kuadër të fushatave kombëtare dhe ndërkombëtare ndërgjegjësuere kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje me bazë gjinore, është përfshirë aktivisht në implementimin dhe realizimin e një kalendari të përbashkët aktiviteteve sensibilizuese në Vlorë.

Bashkia Vlorë, specifikisht Koordinator i Dhunës dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, ka ndërmarrë zhvillimin e aktiviteteve sensibilizuese në 3 kopshte të qytetit ku ka trajtuar temën “*Rolet dhe stereotipet gjinore*” të lidhura me dhunën në familje me bazë gjinore. Për të tilla aktivitete nuk ka buxhet specifik të përcaktuar nga Bashkia, ndërkohë që as për aktivitetet sensibilizuese në shkollë nuk janë shpenzuar fonde.

Aktivitetet kanë konsistuar në informimin me gojë të nxënësve për fenomenin e dhunës. Mungon prodhimi i posterave sensibilizues apo broshurave informuese për çështjet e dhunës me financim të bashkisë. Ky detaj është realizuar nga organizatat e shoqërisë civile që operojnë në Vlorë dhe punojnë në këtë fushë.

OSHC-të që operojnë në bashkinë Vlorë në lidhje me dhunën me bazë gjinore:

- 1- Qendra Psiko-sociale “Vatra”
- 2- Qendra Rinore e Vlorës
- 3- Qendra “Aulona”
- 4- World Vision- dega Vlorë
- 5- Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social

Qendra Vatra dhe Koordinator i dhunës, Zyra e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale kanë luajtur rol të rëndësishëm në inicimin dhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta që u realizuan gjatë 16 Ditëve Të Aktivizimit Kundër Dhunës Me Bazë Gjinore. Aktorët që ndërmorën aktivitetet ishin: Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Bashkia Vlorë, Shërbimi Social Rajonal, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria e Policisë Vendore, Zyra e Përmbartimit, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Qendra Rinore Shtetërore, Qendra Aulona, Qendra Për Zhvillim dhe Promovim Social dhe Qendra Rinore Vlorë, të cilët realizuan 13 aktivitete. Në total u realizuan 16 aktivitete ndërgjegjësuere.

Bashkëpunimi i bashkisë Vlorë me institucione lokale shtetërore dhe joqeveritare, në fushën e parandalimit dhe sensibilizimit ndaj çështjeve të dhunës dhe trafikimit gjatë vitit 2018 ka qenë i ngushtë dhe shumë i mirë. Ndërkohë mungon bashkëpunimi i Bashkisë me organizata ndërkombëtare në kuadër të të tillave fushatave.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	26 nëntor 2018	Marshim Publik	#MëDëgjodheMua	Qendra "Vatra", Qendra Rinore e Vlorës, Bashkia Vlorë, Shërbimi Social Rajonal, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Qendra Aulona, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social, Qendra Rinore Rajonale si dhe World Vision
2	26 nëntor 2018	Fakulteti Juridik, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"	Forum "Pabarazitë dhe dhuna me bazë gjinore - perceptimet dhe roli i të rinjve"	Rrjeti Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) dhe Qendra Psiko-Sociale "Vatra" Vlorë, në bashkëpunim me Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe me mbështetjen e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida
3	27 nëntor 2018	Qendra Vatra	Seancë informuese me gra dhe vajza përfituese së skemës së ndihmës ekonomike	Qendra Vatra dhe Drejtora e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashkinë Vlorë
4	27 nëntor 2018	Këndi Amerikan Vlorë	Eksplorojmë sigurinë publike për vajzat" ushtrim në grup i kombinuar me punë praktike	Vlora Youth Center
5	3 dhjetor 2018	Drejtoria e Formimit Profesional në Vlorë	seancë informuese me gra dhe vajza që ndjekin kurse profesionale	Qendra Vatra, Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë, Drejtoria e Formimit Profesional në Vlorë
6	3 dhjetor	Kopështi Nr 10	Bisedë mbi rolet gjinore	Koordinatori vendor i dhunës dhe Njësia për mbrojtjen e fëmijëve

7	4 dhjetor 2018	Shkolla e mesme "Mustafa Qemal Atatürk"	Seancë informuese	Qendra "Vatra", Bashkia Vlorë, Drejtoria Vendore e Policisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik dhe Qendra "Aulona" në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë.
8	5 dhjetor 2018	Shkolla industriale "Pavarësia", Vlorë	Seancë informuese	Qendra "Vatra", Bashkia Vlorë, Drejtoria Vendore e Policisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik dhe Qendra "Aulona" në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë.
9	6 dhjetor 2018	Qendra Vatra	seancë informuese me gra dhe vajza viktime të dhunës përfituese të Qendrës Vatra	Qendra Vatra, Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale në Bashkinë Vlorë.
10	25 nëntor – 10 dhjetor 2018	media sociale	Fushatë ndërgjegjësimi mbi parandalimin e dhunës me bazë gjinore	Qendra Vatra, Qendra "Aulona", Qendra Rinore e Vlorës, Qendra Rinore Rajonale dhe Drejtoria e Shëndetit Publik
11	5 dhjetor 2018	Kopështi Nr 1	Bisedë mbi rolet gjinore	Koordinatori vendor i dhunës dhe Njësia për mbrojtjen e fëmijëve
12	6 dhjetor 2018	Shkolla 9-vjecare "Mynyr Xhindi", Njësia Administrative Vllahine, bashkia Selenice	Sesion informues "Rritja e aksesit të viktimave të të gjitha llojeve të dhunës në drejtësi"	Qendra Vatra, Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social Vlore
13	6 dhjetor 2019	Shkolla 9-vjecare "Qani Nuredini", Njësia Administrative Sevaster, Bashkia Selenice	Sesion informues "Rritja e aksesit të viktimave të të gjitha llojeve të dhunës në drejtësi"	Qendra Vatra, Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social Vlore

14	6 dhjetor 2018	Shkolla, qendra shëndetësore, ambiente publike	Fushatë sensibilizuese me materiale informuese, fletëpalosje, me mesazhe kundër dhunës.	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Vatra
15	6 – 7 dhjetor 2018	Shkolla Artistike “Naim Frashëri”, Vlorë	Ekspozitë me piktura kundër dhunës në familje	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Shkolla Artistike “Naim Frashëri”, Vlorë
16	7 dhjetor 2018	Kopështi Nr 2	Bisedë mbi rolet gjinore	Koordinatori vendor i dhunës dhe Njësia për mbrojtjen e fëmijëve

Burimi: Bashkia Vlorë

Gjithashtu u realizuan nga Drejtoria Vendore e Policisë Qendra Vatra, Bashkia Vlorë, Prefektura e Qarkut Vlorë, Sherbimi Social Rajonal, Drejtoria e Shëndetit Publik, Qendra Aulona dhe Qendra Rinore Rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë, 4 seanca informuese mbi temën “*Dhuna me bazë gjinore. Shkaqet dhe Pasojat. Raportimi dhe institucionet përgjegjëse*”.

Data	Shkolla	Qyteti/Fshati	Nr pjesëmarrësve
9 nëntor 2018	Ali Demi	Vlorë	120
13 nëntor 2018	Jani Minga	Vlorë	40
16 nëntor 2018	Pavarësia	Vlorë	21
19 nëntor 2018	Halim Xhelo	Orikum, Vlorë	27
Total			208 nxënës

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, datë 8 mars 2018, Qendra Psiko-Sociale "Vatra" organizoi së bashku me organizata dhe institucione të bashkisë Vlorë një aktivitet sensibilizues ku u shpërndanë materiale informuese për komunitetin. Të pranishëm në aktivitet ishin përfaqësues nga bashkia Vlorë dhe mediat lokale të cilat pasqyruan aktivitetin në programacionin e tyre.

Për të vijuar, më datë 14 Qershor 2018, Qendra “Aulona” organizoi aktivitetin me temë "Sfidat dhe arritjet e GTM në adresimin e rasteve të dhunës në rrethin e Vlorës", me pjesëmarrjen e të gjithë aktorevë pjesë e Grupit Teknik Multidisiplinar, në Vlorë. Takimi u zhvillua në funksion të rritjes së efikasitetit në adresimin e nevojave të viktimave të

dhunës në familje. Pjesëmarrës në takim ishin: Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Vlorë, Drejtoria Arsimore Rajonale Vloree, Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Qendra Rinore Rajonale Vloree, Bashkia Vloree, Shërbimi Social Shtetëror Qarku Vlore, Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social dhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë.

Megjithëse Objektivi 3.1 i strategjisë kërkon gjithashtu edhe koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta, në Vlorë nuk ka akoma një bashkëpunim apo/dhe koordinim të tillë.

Gjatë muajit mars 2018 midis Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në bashkinë Vlorë dhe Policisë u vendos një marrëveshje bashkëpunimi në funksion të mirë-manaxhimit dhe zgjidhjes së rasteve. Nëpërmjet kësaj shkrese, DNESHSH kërkon mundësimin e komunikatave mujore për shtyp të rasteve të dhunës për Bashkinë Vlorë dhe numrat e kontaktit për çdo rast dhune të paraqitur pranë DVPV.

Gjatë muajit mars 2018, koordinatori vendor i është drejtuar Gjykatës së rrethit, Zyrës së Kancelares me kërkesë “bashkëpunim institucional” për shkëmbim informacioni, me qëllim vendosjen e kontakteve në kohë reale me rastin dhe sigurimin e statistikave.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanizmi Rajonal i Referimit (MRR) në Bashkinë Vlorë funksionon në bazë të një marrëveshje të nënshkruar që prej vitit 2011. Në funksion të ngritjes dhe mirëfunksionimit të Mekanizmit të Referimit, vazhdon të jetë funksionale përgjatë viteve, Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokuroria e rrethit Vlorë, Zyra e Përmbarimit Vlorë, Mjeku Ligjor, Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë, Spitalit të Përgjithshëm Vlorë, Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, Zyra e Punësimit Vlorë, Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, e datës 22.02.2011.

Përgjatë vitit 2018 MRR në Bashkinë Vlorë ka realizuar dy mbledhje të Komitetit Drejtues. Krahasuar me vitet e kaluara ku nuk është realizuar asnjë mbledhje e MRR, kjo vlerësohet si ecuri pozitive.

Gjithashtu, gjatë datave 29 dhe 30 mars 2018 janë realizuar dy takime me temë “*Vizitë studimore për shkëmbim eksperience midis Mekanizmit të Referimit dhe trajtimin të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare të ngritur në Bashkinë Vlorë, Mallakastër dhe Tepelenë. Arritjet dhe sfidat*”, të organizuara nga Bashkia Mallakastër dhe Bashkia

Tepelenë, në Vlorë. Takimet janë realizuar në kuadër të një projekti që po zbatohet në bashkinë Mallakastër. Projekti synon rritjen e raportimit të rasteve të dhunës nëpërmjet aktiviteteve me qëllim ndërgjegjësues, duke qenë se në krahasim me bashkitë e tjera numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje është goxha i ulët.

Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2018, Grupi Teknik Ndërdisciplinar ka trajtuar 11 raste viktime të dhunës në familje. Mbledhjet e GTN-së janë realizuar në kohën e duhur, në përputhje me problematikat e çdo rasti të trajtuar. Specialistët e GTN kanë ofruar shërbimet përkatëse të nevojshme për ndërhyrjen dhe manaxhimin e rasteve, si:

- strehim urgjent;
- asistencë/këshillim ligjor dhe asistencë/këshillime psikologjike pa pagesë;
- mbështetje financiare nëpërmjet paketave ushqimore;
- ndërmjetësim për formim profesional dhe punësim;
- ndërmjetësim për lehtësim në akses dhe ofrim shërbimesh;
- mundësimi në kohë i çertifikatave personale/familjare për rastet viktime të dhunës;
- hartimi i kërkesë padive;
- akomodim emergjent i fëmijëve në institucione të përkujdesit;
- ndërmjetësim për akomodim në strehëza/qendra kombëtare rehabilituese;
- ndërmjetësim për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike, etj.

Ashtu sikurse është gjetur edhe në dokumentin e parë raportues, vazhdojnë të mbeten të njëjta institucionet e angazhuara aktivisht në mbledhjet e GTN, të cilat janë: Policia, Qendra “Vatra”, Njësia për Mbrojtjen e fëmijëve, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Shërbimi Social Rajonal, Shtëpia e Fëmijës dhe Gjendja Civile Vlorë.

Mospresent në mbledhje vazhdojnë të jenë Zyra e Përmbartimit dhe Drejtoria Rajonale Arsimore. Në këto kushte, janë gjetur rrugë alternative bashkëpunimi me këto institucione, siç është komunikimi nëpërmjet telefonit apo postës elektronike.

Vlen të përmendet kontributi që jep Gjykata e Shkallës së Parë dhe Prokuroria (*pavarësisht mosprezencës fizike në mbledhjet e GTN*) në ofrimin e të dhënave mujore dhe vjetore në lidhje me dhunën në familje/me bazë gjinore.

Një tjetër anë pozitive në Bashkinë Vlorë është edhe qëndrueshmëria (*mosndërrimi i shpeshtë*) e specialistëve që përfaqësojnë institucionet në këto mbledhje dhe prania (*ushtrimi i aktivitetit*) e organizatave joqeveritare të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së në vitin 2018 në Bashkinë Vlorë

Data	Mbledhjet e GTN
8.5.2018	U trajtua rasti i një gruaje viktimë e dhunës në familje, nënë me dy fëmijë minorenë. Rasti u referua pranë Koordinatorit nga Sektori i Dhunës në Polici me datë 6 Maj 2018 pas pajisjes së saj me UMM, e cila identifikoi nevojat e rastit dhe e referuan pranë strehëzës Vatra ku qëndroi e akomoduar për 9 ditë. Gjatë kësaj periudhe, ajo u mbështet me paketën e shërbimeve të programit që ndjek Qendra Vatra, me asistencë ligjore nga avokatët e qendrës, shpërngulje të gjendjes civile dhe rregjistrim të fëmijëve në gjendjen civile. Ndërkohë, me datë 8 maj u mbledh GTN i drejtuar nga Koordinatori Vendor me qëllim ndërmjetësimin për akomodimin e rastit pranë Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Tiranë. Rasti u transferua drejt QKTVDH me shoqërimin e Policisë dhe punonjëses sociale të qendrës Vatra. Duke qenë se ajo ishte banore e Bashkisë Selenicë, koordinatori vendoi referoi rastin për monitorim drejt bashkisë në fjalë.
17.5. 2018	U trajtua rasti i një gruaje viktimë e dhunës në familje, nënë me një fëmijë të rritur. Rasti u referua pranë Koordinatorit nga Sektori i Dhunës në Polici, e cila identifikoi nevojat e rastit së bashku me avokatin e Qendrës Vatra për këshilime ligjore. U mbledh GTN i drejtuar nga Koordinatori Vendor me qëllim diskutimin dhe manaxhimin e çështjes së strehimit. Gruaja ishte e pajisur me UMM. U ndërmjetësua për konsultë me mjekun psikiatër. Rasti është këshilluar disa herë dhe është rikthyer drejt familjes së saj së origjinës.
22.5. 2019	U trajtua rasti i një gruaje viktimë e dhunës në familje, nënë me një fëmijë të mitur. Rasti u referua pranë Koordinatorit nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra” duke qenë se rasti u drejtua për herë të parë për ndihmë aty. Nga mbledhja e GTN, Vatra mundësoi asistimin ligjor të gruas në Gjykatë për procesin e zgjidhjes së martesës dhe asistencë psikologjike për fëmijën. Ndërkohë ajo ishte larguar nga bashkëshorti dhunues dhe ishte rikthyer pranë familjes së origjinës. Nisur nga kushtet e vështira ekonomike të familjes, koordinatori vendor, Policia dhe Qendra Vatra ndërmjetësuan për transferimin e rastit dhe fëmijës së saj pranë QKTVDH në Tiranë. Aktualisht, ajo është rikthyer në Vlorë dhe po mbështetet financiarisht nga një organizatë joqeveritare me apartament me qera për një periudhë të përcaktuar kohore.
24.5. 2019	U trajtua rasti i një gruaje viktimë e dhunës në familje, nënë me dy fëmijë të mitur. Rasti u referua pranë Koordinatorit nga Policia, pas kallëzimit për dhunë në familje që rasti ngriti ndaj bashkëshortit. Nga mbledhja e GTN, pas vlerësimit të nevojave, gruaja u referua për punësim te Drejtoria Rajonale e Punësimit dhe për asistencë ligjore dhe psikologjike pranë Qendrës Vatra.
18.6. 2019	U trajtua rasti i një gruaje viktimë e dhunës në familje, nënë me një fëmijë të mitur. Rasti u referua pranë Koordinatorit nga Policia, pas kallëzimit për dhunë në familje që rasti ngriti ndaj bashkëshortit. Nga mbledhja e GTN, pas vlerësimit të nevojave, gruaja u orientua dhe informua mbi programin e Bonusit se qerasë në bashki dhe referim pranë Qendrës Vatra për asistencë ligjore dhe psikologjike.
2.7.2019	U trajtua rasti i një gruaje viktimë e dhunës në familje, nënë me dy fëmijë të mitur. Rasti u referua pranë Koordinatorit më datë 2 korrik nga Sektori i

	Dhunës në Polici. Në momentin e paraqitjes së gruas në Polici, u njoftua koordinatori vendor, avokati dhe psikologu i Vatrës dhe u ngrit menjëherë GTN. Rasti u akomodua pranë strehëzës Vatra po atë datë. Gjatë 3 ditëve të strehimit ajo u mbështet me paketën e shërbimeve të programit që ndjek Qendra Vatra. Me vullnetin e saj të lirë u largua nga programi i Vatrës dhe u rikthye pranë bashkëshortit.
18.7.2019	U trajtua rasti i një nëne viktimë e dhunës në familje me 6 fëmijë të mitur. Pas identifikimit të nevojave nga Koordinatori vendor, u thirr GTN dhe u realizua: referimi për punësim te Drejtoria Rajonale e Punësimit; referim asistencë ligjore dhe psikologjike pranë Qendrës Vatra për zgjidhje martesë dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijëve. Është mundësuar punësimi i rastit pranë një biznesi privat.
29.8.2019	U trajtua rasti i një nëne viktimë e dhunës në familje me 5 fëmijë të mitur. Pas identifikimit të nevojave nga Koordinatori vendor, u thirr GTN dhe u realizua: mbështetje financiare me paketë ushqimore nga Qendra Vatra, ndërmjetësim për përfshirje të familjes në skemën e ndihmës ekonomike, etj.
4.9.2019	U trajtua rasti i një nëne viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë të mitur. Pas identifikimit të nevojave nga Koordinatori vendor, u thirr GTN dhe u realizua: referimi për punësim te Drejtoria Rajonale e Punësimit dhe regjistrim i fëmijëve në kopësht shtetëror.
11.9.2019	U trajtua rasti i një nëne viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë të mitur. Pas identifikimit të nevojave nga Koordinatori vendor, u thirr GTN dhe u realizua: referim për asistencë ligjore dhe psikologjike pranë Qendrës Vatra për zgjidhje martesë dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijëve, informim me qëllim përfshirjen e familjes në skemën e ndihmës ekonomike, informim mbi UM.
10.10.2019	U trajtua rasti i një nëne viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë të mitur. Pas identifikimit të nevojave nga Koordinatori vendor, u thirr GTN dhe u realizua: referim për asistencë ligjore dhe psikologjike pranë Qendrës Vatra për zgjidhje martesë dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijëve, referim për punësim te Drejtoria Rajonale e Punësimit; referim pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Shërbimit Psiko-social të DAR për regjistrim të fëmijëve në shkollë dhe ndjekje e fëmijëve me këshillime psiko-sociale.
23.10.2019	U trajtua rasti i një nëne viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë të mitur. Pas identifikimit të nevojave nga Koordinatori vendor, u thirr GTN dhe u realizua: referim për asistencë ligjore dhe psikologjike pranë Qendrës Vatra për zgjidhje martesë dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijëve, mbështetje financiare me paketë ushqimore dhe pagesën e padisë për zgjidhje martesë nga Qendra Vatra dhe referim për punësim te Drejtoria Rajonale e Punësimit.

Burimi: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Vlorë

Sipas informacioneve të përfituara nga kjo bashki dhe nga analiza bazuar në tabelën e mësipërme, theksohet se rastet janë trajtuar në kohë shumë të shpejtë nga GTN-ja e Bashkisë Vlorë. Përveç mbledhjeve të GTN të realizuara pranë Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, koordinatori vendor ka realizuar mbledhjen e GTN edhe pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë, në rastet emergjente ku është nevojitur ndërhyrja

direkte për manaxhimin e rastit. Gjithashtu, vihet re bashkëpunimi i ngushtë midis aktorëve lokal si Bashkia, Policia, Qendra Vatra, Drejtoria Rajonale e Punësimit.

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të KD-së në vitin 2018 në Bashkinë Vlorë

Data	Mbledhjet e KD
21.6.2018	<i>Mbledhja e parë</i> – Kjo datë shënoi mbledhjen e parë të MRR për vitin 2018. Të pranishëm ishin të gjithë drejtuesit e institucioneve anëtare të MRR-së. Në mungesë të kryetarit të bashkisë, mbledhja u drejtua nga drejtori i Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në bashkinë Vlorë.
20.11. 2018	<i>Mbledhja e dytë</i> – Kjo mbledhje u relizua në kuadër të fushatës 16 Ditë të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Takimi u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe koordinatori vendor i dhunës në familje. Të pranishëm ishin të gjithë drejtuesit e institucioneve anëtare të MRR-së dhe specialistë të angazhuar në mbledhjet e GTM. Ndër çështjet kritike që u trajtuan në fjalën e hapjes së kryetarit të bashkisë ishin: strehimi social për viktimat e dhunës dhe fëmijët e tyre, skema e ndihmës ekonomike, ngritja e një qendre sociale ditore, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional. Gjatë mbledhjes u ndanë gjetjet e monitorimit mbi funksionimit të MRR në bashkinë Vlorë gjatë vitit 2017 dhe u diskutua mbi mundësinë e përmirësimit të punës së këtij mekanizmi.

Burimi: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Vlorë

Ndërkohë që lidhur me numrin e raporteve që ndan koordinatori me anëtarët e MKR-së, bashkia informon se këto raportime bëhen 2 herë në vit me anëtarë të MKR-së, me rezultatet dhe sfidat e hasura gjatë manaxhimit dhe trajtimit të rasteve të trajtuara gjatë periudhës së raportimit. Kjo metodë është kthyer në praktikë gjatë vitit 2018.

Tabela 7. MRR-ja e Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2018

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Dritan Leli
Drejtorja e Policisë së Qarkut Vlorë	Gentjan Shehaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Skënder Haluci
Prokuroria e Rrethit	Ardian Ylli
Drejtorja Arsimore Rajonale (DAR)	Albana Hodaj
Drejtorja e Shëndetit Publik	Myzafer Islami
Zyra e Përmbartimit	Fitim Koçiaj
Zyra Rajonale e Punësimit	Marjana Cani
Qendra Psiko-Sociale “Vatra”	Brikena Puka
Drejtorja e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë	Ina Islami
Spitali Vlorë	Brunilda Mersini
Mjeku Ligjor	Blerim Peli
Qendra “Aulona”	Enela Mone

Tabela 8. GTN-ja e Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2018

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia Vlorë	Irena Stasa, Rezarta Andoni
Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë	Silvana Ngresi
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Nuk janë prezent
Prokuroria e Rrethit	Nuk janë prezent
Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR)	Jo gjithmonë janë prezent
Drejtoria e Shëndetit Publik	Elsa Bimo
Zyra e Përmbarimit	Nuk janë prezent
Zyra Rajonale e Punësimit	Gjinovefa Xhori
Qendra Psiko-Sociale “Vatra”	Malvina Aliaj, Oliana Manaj
Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë	Eno Koleka
Spitali i Përgjithshëm Vlorë	Nuk janë prezent
Mjeku Ligjor	Nuk janë prezent
Shtëpia e Foshnjes Vlorë	Olta Danaj

Burimi: Bashkia Vlorë

Që prej vitit 2009 bashkia e Vlorës ka bashkëpunim të ngushtë me Qendrën “Vatra”, Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Vlorë dhe Drejtorinë Rajonale të Punësimit. Si e vetmja organizatë që ofron shërbime ligjore dhe psikologjike pa pagesë për gratë dhe vajzat viktimë të dhunës në familje, këto të fundit referohen nga koordinatori pranë Qendrës Vatra. Gjithashtu, me Drejtorinë Rajonale të Punësimit (*për rastet kur kërkohet punësim për viktimën*), Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike pranë bashkisë (*për referimin e viktimës për aplikim për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike*) apo bashkëpunimi është i vazhdueshëm dhe i ngushtë.

Gjatë muajit Shkurt të vitit 2018, me vendim të Këshillit Bashkiak Vlorë është miratuar lista e 14 fëmijëve të viktimave të dhunës për frekuentimin e çerdheve dhe kopshteve me drekë për një periudhë 6 mujore me të ardhurat e bashkisë. Iniciativa u ndërmor nga Aleanca e Grave të Këshillit Bashkiak Vlorë. Kjo listë është hartuar fillimisht nga Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale dhe Qendrës Vatra, të cilat kanë propozuar emrat e fëmijëve të ardhur nga familje vulnerabël me probleme ekstreme ekonomike dhe sociale, pasi është bërë vlerësimi i nevojave të familjeve prej nga fëmijët vijnë.

Ndërkohë, që prej vitit 2014 dhe 2016 koordinatori vendor është trajnuar për përdorimin e sistemit data-bazë për regjistrimin e menazhimit të rasteve të DHF dhe DHBGJ dhe të dhënat hidhen në mënyrë të rregullt dhe në kohë reale. Përdorimi i sistemit është sistematik dhe koordinatori sigurohet që në fund të çdo muaji të gjitha rastet të jenë të evidentuara në sistem. Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur vështirësi në përdorimin e sistemit.

Ndërsa lidhur me bonuset sociale gjatë periudhës janar – dhjetor 2018, asnjë rast viktimë dhune nuk është mbështetur me bonuse sociale, pavarësisht lobimit të organizatave qeveritare në Vlorë. Aplikimi për bonuse sociale qëndron hapur në periudha të caktuara kohore. Kjo bën që skema të mos jetë fleksibël dhe të mos përputhet me dinamikën e rasteve që paraqesin nevoja për strehim emergjent. Përveç kësaj, aplikimi në skemën e bonuseve sociale kërkon një numër të madh dokumentash, ka kosto financiare dhe kërkon kohë fizike për plotësimin e dosjes.

Pranë Bashkisë është emëruar Specialistja e lartë për Dhunën në Familje, e cila do të luajë rolin e Koordinatorës vendore. Znj. Rezarta Andoni, e emëruar në këtë pozicion, është e gatshme të informojë të gjitha institucionet/aktorët e interesuar për sa i takon sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje.

Pozicioni i koordinatorit vendor për bashkinë e Vlorës është krijuar në nëntor 2009 dhe detyrat janë kryer nga i njëjti person që prej emërimit të saj si Specialiste e Lartë për Dhunën në Familje, ku luan rolin e Koordinatorit Vendor. Detyrat janë specifikuar edhe në Rregulloren e re të bashkisë Vlorë, gjatë periudhës shtator-tetor të vitit 2017. Kjo rregullore është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë.

Gjatë vitit 2018 koordinatorja vendore e dhunës në familje nuk është trajnuar në tema që lidhen me dhunën. Koordinatorja ka qenë pjesë e tryezave konsultative për ngritjen e qendrave të emergjencave për viktimat e abuzimit/dhunës seksuale, tryezë e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Maj 2018. Gjithashtu, ka qenë pjesë e një takimi ndërorgjesisht organizuar nga Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar për viktimat e dhunës me aftësi të kufizuar.

Në lidhje me përmirësimin e kapaciteteve të koordinatorit vendor, ajo ka marrë pjesë në dy trajnime gjatë kësaj periudhe:

1. Trajnim mbi çështjet e LGBTI për nënpunësit gjinorë në bashkitë e pjesës jugore të Shqipërisë organizuar në datat 6-7.02.2018 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Europës *“Për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Diskriminimit të Bazuar në Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor në Shqipëri dhe në Bashkimin Europian”*.

2. Trajnim mbi “Çështjet e Ligjit për Profesionistet që Punojnë me Fëmijët” organizuar në datat 20-22 Qershor 2018 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) në bashkëpunim me Organizatën World Vision Albania .

Nuk janë zhvilluar trajnime të përbashkëta me anëtarët e MRR. Trajnimi i fundit është zhvilluar gjatë vitit 2014 ku është prezantuar Manuali i Përdorimit për manaxhimin e rasteve të dhunës.

Paga e koordinatores përbën përqindjen e buxhetit vjetor që mbështet qendrueshmërinë e këtij pozicioni. Nuk është alokuar në buxhetin e bashkisë së Vlorës asnjë mundësi tjetër financiare për të mbështetur materiale promovuese. Materialet promovuese (*broshura, fletë-palosje, banera*) janë prodhuar dhe shpërndarë nga organizata të shoqërisë civile, në kuadër të programeve dhe projekteve që ata ndjekin dhe implementojnë. Gjithashtu, aktivitetet sensibilizuese të iniciuara nga Koordinatorit vendor (Bashkia) përgjatë datave 25 nëntor – 10 dhjetor 2019 janë aktivitete pa kosto financiare.

Sipas Koordinatorit vendor, nuk ka zë specifik në buxhet dedikuar mirëfunksionimit dhe veprimtarisë së MKR.

Bashkëpunimi me Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Vlorë ka qenë pozitiv dhe i ngushtë përgjatë vitit 2018. Vazhdon rutina e përcjelljes së informacionit midis Sektorit të Dhunës në Familje dhe të Miturve dhe koordinatorit vendor, mbi rastet viktime të dhunës të paraqitura pranë komisarariatit të Policisë Vlorë. Gjatë mbledhjeve të GTN specialistja e dhunës në familje pranë Policisë është gjithmonë prezente, duke luajtur rol aktiv në diskutimin, trajtimin dhe manaxhimin e rasteve. Gjithashtu, janë përfshirë aktivisht dhe kanë iniciuar zhvillimin e seancave informuese në shkolla në ditë të caktuara që përputhen me fushata kombëtare apo ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe, policia ka mundur transportin e dy rasteve viktime të dhunës dhe tre fëmijëve të tyre, nga Vlora drejt QKPVDH në Tiranë, së bashku me qendrën Vatra.

Vlen të theksohet se gjatë procesit të hartimit të listës së 14 fëmijëve për frekuentimin e çerdheve dhe kopështeve me drekë, është kërkuar informacion i detajuar edhe nga Seksioni i Çështjeve të Dhunës në Familje dhe të Miturve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, e cila ka siguruar të dhëna mbi familjen, të tilla si: adresën e vendbanimit, numra kontakti dhe informacion nëse nëna e fëmijës është pajisur me UM, UMM apo ka çështje të hapura penale. Pas sigurimit të këtyre të dhënave, janë realizuar verifikime nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale nëpërmjet vizitave në familje.

Përgjatë vitit 2018, statistikave tregojnë se kërkesat për UM dhe UMM janë plotësuar të gjitha nga Drejtoria Vendore e Policisë. Kjo përbën risi krahasuar me vitet e kaluara, ku rastet që kërkonin të pajiseshin me UM/UMM i drejtoheshin organizatave jofitimprurëse.

Gjatë muajit mars 2018, koordinatori vendor i është drejtuar Gjykatës së rrethit, Zyrës së Kancelares me kërkesë “bashkëpunim institucional” për shkëmbim informacioni, me qëllim vendosjen e kontakteve në kohë reale me rastin dhe sigurimin e statistikave.

Gjykata mban kontakte të përmuajshme nëpërmjet korrespondencës më postë elektronike me koordinatorin vendor. Ajo ofron informacion në lidhje me numrat e kontakteve të viktimave të viktimave që pajisen me UMM duke i mundësuar koordinatorit vlerësimin në kohë reale të nevojave dhe referimin e rasteve tek ofruesit e shërbimeve/aktorët përgjegjës.

Çdo fund muaji, 3 muajor, 6 muajor dhe çdo fund viti, gjykata ndan me koordinatorin vendor të dhëna statistikore të rëndësishme lidhur me viktimat e dhunës në familje të asistuar nga institucioni në fjalë, duke bërë një analizë të detajuar të profilit të tyre, llojit të çështjeve, etj.

Krahasuar me vitet e kaluara, ku mungonin të dhënat statistikore nga Gjykata në lidhje me ndëshkimin e dhunuesve, me koordinatorin vendor janë ndarë raporte të përpunuara vjetore të vitit 2018 dhe informacion në lidhjen me numrin e personave të gjykuar/dënuar, masën e dënimit etj.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile vazhdon të jetë i rregullt dhe i ngushtë. Që prej vitit 2009 ka atashuar pranë zyrave të Qendrës “Vatra” specialisten e dhunës në familje. Ndërkohë nga muaji prill 2018, Qendra Psiko-Sociale “Vatra” në kuadër të projekteve që implementon, ka ngritur Klinikën Ligjore e cila ka ofruar shërbime komunitare Ligjore dhe Psikologjike, për viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës. Në këtë projekt Vatra po bashkëpunon me Qendrën për Zhvillim dhe Promovim Social, Vlorë e cila me ekspertë të saj ka ofruar shërbimin psikologjik të specializuar për fëmijë duke përfshirë edhe dhënien e vlerësimeve psikologjike në Gjykatë.

Gjatë vitit 2018 Klinika Ligjore Vatra ka asistuar:

- 225 raste (195 raste të reja dhe 30 raste të përsëritura) të cilët kanë marrë shërbim ligjor. 77 prej të tyre janë këshilluar nga ana ligjore dhe 148 raste janë asistuar në institucione si Gjykatë, Prokurori, Polici, etj.

- 167 raste në total (156 raste të reja dhe 11 të përsëritura) të cilët kanë marrë shërbim psikologjik. 96 raste janë gra dhe vajza viktimat e dhunës dhe 71 raste janë fëmijë.

Ndërkohë në vijim kjo organizatë ka organizuar një sërë aktivitetesh të tjera përgjatë vitit 2018 si:

- Trajnimin e 20 studentëve të Fakultetit të Drejtësisë me temë “*Legjislacioni shqiptar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të viktimave të dhunës dhe viktimave të trafikimit*”. Studentët e trajnuar janë bërë pjesë e grupeve pro-bono dhe janë angazhuar vullnetarisht në hartimin e akteve ligjore të rasteve që mbështeten në Klinikën Ligjore, studimin e dosjeve, monitorimin e proceseve gjyqësore, etj.

- Organizimin e një forumi me studentë të Departamentit të Drejtësisë të Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”, Vlorë, me pjesëmarrjen e 65 studentëve, me temë “*Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar në brojtje të viktimave të dhunës dhe trafikimit të personave*”
- Organizimin e 13 sesione informuese me vajza, gra dhe burra nga komuniteti në njësitë administrative të qarkut të Vlorës, me pjesëmarrjen e 267 anëtarëve të komunitetit.
- Organizimin e 16 sesione informuese me nxënës të shkollave 9- vjeçare, në zonat rurale dhe periferike të Vlorës, me pjesëmarrjen e 384 nxënësve.
- Realizimin e një bisede në një prej radiove lokale të Vlorës ku u prezantua projekti, objektivat e tij dhe shërbimet që do të ofrohen në Klinikën Ligjore për komunitetin e Vlorës dhe më gjerë.
- Publikimin e një fletëpalosje e cila ka në përmbajtje informacion mbi projektin dhe shërbimet e ofruara nga Klinika Ligjore “Vatra”.

Koordinatori vendor ka referuar drejt Qendrës Vatra çdo rast viktimë dhune për të cilën ka vlerësuar nevojën për informim, këshillim ose/dhe asistencë ligjore dhe këshillimi/ seanca psikologjike. Përgjithësisht, llojet e çështjeve kanë qenë: marrja e UMM dhe UM në Gjykatë, procedim penal për dhunë dhe abuzim, zgjidhje martesë, ndryshim/rritje e pensionit ushqimor për fëmijët, vendosje e fëmijës në kujdestari, kundërshtim/njohje atësie për të bërë më pas rregjistrimin e fëmijëve, regjistrim femije ne Gjendjen Civile, heqje e përgjegjësisë prindërore, vërtetim fakti juridik-lindjeje të fëmijëve të parregjistruar, ndreqje gabimi material në akt lindje apo çertifikatë lindje të fëmijëve, pavlefshmëri akt-lindje, vërtetim fakti juridik në marrëdhënie pune, etj.

Rastet janë asistuar dhe shoqëruar nga avokatët e qendrës në institucione të ndryshme si: Polici, Prokurori, Gjykatë, Zyra e Përmbarrimit, Zyra të Gjendjes Civile, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Bashki, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, etj.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Qendrën ”Aulona”, për përfitueset viktime të dhunës të akomoduar pranë strehëzës Vatra janë realizuar vizita dhe konsulta gjinekologjike pa pagesë.

Bashkëpunimi me Shërbimin Social Rajonal vazhdon me të njëjtat ritme dhe zhvillime si në vitin 2017. Bashkëpunimi konsiston në mbështetjen dhe ndërmjetësimin institucional në rangje të larta. Kjo ndodh pasi ShSR ka kompetencën ti kërkojë ndihmë Shërbimit Social Shtetëror Tiranë për akomodimin e rasteve të dhunës në qendra rezidenciale shtetërore. Megjithatë, specialistë nga ky institucion janë gjithmonë pjesë aktive gjatë mbledhjeve të GTN.

Gjatë vitit 2018, koordinatori ka referuar 10 raste pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit. Referimi është realizuar gjatë mbledhjeve të GTN ose nëpërmjet telefonit dhe postës

elektronike. Specialistë të DRP janë gjithmonë prezent në mbledhjet e GTN-së. Gjithashtu, edhe Qendra Vatra ka referuar për punësim dhe regjistrim në kurse të formimit profesional pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional 24 vajza dhe gra viktime të dhunës në familje.

Sfidë mbetet kufizimi në llojet e punës (*fasoneri*), oraret e punës jo të favorshme dhe të përshtatshme për nëna me shumë fëmijë, pagat e ulta etj. Megjithatë, duhet theksuar se sfidat lidhen ngushtësisht edhe me nivelin e ulët arsimor të viktimave, mospasjen e një profesioni apo mos praktikimin e tij.

Drejtorja Arsimore Rajonale i është përgjigjur në kohë kërkesave apo referimeve të rasteve të koordinatorit vendor. Kanë qenë prezent dhe aktiv në mbledhjet e GTN për rastet kur është nevojitur ndërhyrja e tyre (*regjistrim i fëmijëve të përfituesve në shkollë, ndërmjetësim për rifrekuentimin e shkollës, ndjekje e nxënësve me këshillime psiko-sociale nga Shërbimi Psiko-Social në DAR etj*). Gjithashtu, DAR ka shprehur bashkëpunimin e hapur në mundësimin dhe lehtësimin e seancave informuese në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të Vlorës gjatë fushatave sensibilizuese.

Shërbimi i Provës është institucion i cili nuk përfaqësohet asnjëherë në mbledhjet e GTN. Nuk ka diferencë ndërmjet viteve lidhur me bashkëpunimin institucional. Përveç kësaj mungon edhe komunikimi midis koordinatorit dhe kësaj strukture (*koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për tu trajtuar me programe të tilla*). Gjithashtu koordinatori nuk ka informacion mbi format e aplikuar të shërbimeve apo kohëzgjatjen e shërbimit.

Bashkëpunimi me njësitë administrative në bashkinë Vlorë mbetet i moderuar. Nga Rajoni Nr.5 Bashkia Vlorë gjatë vitit 2018 janë referuar tek koordinatori vendor 5 raste të cilat kanë bërë kërkesë për UMM, u është bërë vlerësimi i nevojave, janë orientuar në polici dhe janë referuar te ofruesit e tjerë të shërbimeve si psh Vatra, Aulona, Zyra e Punësimit etj. Këto raportime janë njoftuar nëpërmjet telefonatave.

Gjatë muajit shkurt 2018, administratorët social janë bërë me dijeni nga DNSHS dhe koordinatori vendor për referimin e fëmijëve të grave viktime të dhunës në familje. Gjatë 3 muajit të dytë të vitit 2018, së bashku me administratoren shoqërore të Rajonit Nr.2 është bërë monitorimi i banesës së një rasti, viktimë e dhunës në familje. Ndërkohë që prezenca e tyre në mbledhjet e GNT nuk është e rregullt.

Në bazë të informacioneve, bashkia Vlorë vazhdon të paraqesë të njëjtat nevoja emergjente për manaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës: mungesa e banesave sociale për strehim dhe akomodim të rasteve viktime të dhunës; të mos pasurit e një zëri specifik buxheti për mirëfunksionimin e MRR; mungesa e një mjete transporti në manaxhimin e bashkisë për transportin fizik të viktimave të dhunës në qendra të specializuara.

Bashkëpunimi me Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje në Tiranë gjatë periudhës janar – dhjetor 2018 ka funksionuar relativisht mirë. Në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” dhe Drejtorinë Vendore të Policisë, gjatë vitit 2018 është ndërmjetësuar dhe realizuar akomodimi i 4 rasteve gra viktimë të dhunës në familje dhe 7 fëmijëve të tyre pranë kësaj qendre. Koordinatori thekson se komunikimi me këtë institucion ka kërkuar herë pas herë ndërmjetësimin e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” dhe Shërbimit Social Shtetëror për akomodimin e rasteve pranë kësaj qendre rezidenciale.

Rast suksesi i Mekanizmit të Referimit:

“Gjatë muajit maj të vitit 2018 është referuar pranë Strehëzës Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje në Tiranë një grua viktimë e dhunës në familje dhe dy fëmijët e saj. Rasti u paraqit gjatë ditëve të para të muajit maj në polici ku kallzoi dhunën fizike dhe psikologjike që bashkëshorti i saj ushtronte mbi të. Psikologu i Qendrës Vatra asistoi rastin dhe dy fëmijët e mitur në Komisarjatin e Policisë Vlorë që në momentin që rasti dhe fëmijët u paraqitën në institucion. Bazuar në vlerësimin e nevojave të rasti, me qëllim ardhjen në ndihmë dhe strehimin urgjent, policia e referoi gruan dhe dy fëmijët për akomodim pranë strehëzës Vatra. Më datë 8 maj, u mbledh GTN, u shqyrtua rasti dhe u diskutua në terma të akomodimit afatgjatë pranë Qendrës Kombëtare për Viktimat e Dhunës. Pas 9 ditësh strehim në strehëzën “Vatra”, pasi u asistua me paketën e shërbimeve që Vatra ndjek, rasti dhe dy fëmijët e saj të mitur u shoqëruan drejt QKVDH, në prani të punonjësit social të Qendrës Vatra dhe punonjësit të policisë. Familja qëndroi e akomoduar pranë QKVDH përreth 8 muaj, deri në fund të vitit 2018. Aktualisht ajo po mbështetet financiarisht nga një organizatë joqeveritare me apartament me qera për një periudhë të përcaktuar kohore. Krahasuar me kohën kur gruaja vendosi kontaktet e para me aktorët e lartë përmendur, gjendja e saj psikologjike është përmirësuar ndjeshëm. Mban kontakte të rregullta me koordinatoren dhe Qendrën Psiko-Sociale Vatra.”

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Në bazë të statistikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me autorët e veprave penale dhe dhënien e masës së dënimit për ta, vihet re se për 224 viktima të dhunës në familje (bashkia Vlorë) janë gjykuar në total 62 autorë, prej të cilëve janë dënuar si autorë të veprës penale 60 persona dhe 2 janë shpallur të pafajshëm.

Janë pushuar për gjykim nga gjykata 3 çështje. Duhet theksuar se prej 60 të dënuarve për ushtrim të dhunës në familje, 8 prej tyre kanë qenë të mitur që i përkasin grupmoshës 16 – 18 vjeç.

Duke bërë një analizë të shkurtër të profilit të 62 rasteve të dënuara për ushtrim të dhunës në familje të trajtuar nga gjykata gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2018, rezulton se 59 prej autorëve të dhunës janë me arsim dhe vetëm 1 është i paarsimuar. Ndërkohë, 58 prej tyre, gjykata i ka dënuar me dënimin deri në 2 vjet burg, 1 autor ka marrë masën e dënimit prej 2 – 5 vjet dhe 1 rast, 5 – 10 vjet.

Ka një sërë shërbimet që mungojnë në bashkinë Vlorë, por një ndër më kryesorët mbetet rehabilitimi i dhunuesve përmes programeve të specializuara. Mungesa e linjës së këshillimit/qendër rehabilitimi për dhunuesit burra; qendër e specializuar shërbimesh për viktimat e dhunës në familje me probleme të shëndetit mendor që paraqesin nevoja urgjente për strehim. Bashkia Vlorë nuk ofron shërbime këshillimi për djemtë dhe burrat dhunues. Në territorin e Bashkisë nuk operojnë organizata të specializuara që ndjekin programe rehabilituese për dhunuesit. E vetmja strukturë që ofron shërbime këshillimi për djemtë dhe burrat dhunues është Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.

Bashkëpunimi me Zyrën e Përmbartimit dhe bashkisë Vlorë mungon totalisht. Nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi/shkëmbim informacioni. Nuk janë trajtuar/manaxhuar raste që kanë pasur nevojë për ndërhyrjen e zyrës së përmbartimit. Nuk kanë qenë prezent në asnjë takim, situatë kjo e njëjtë me një vit më parë.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Vlorës për vitin 2018, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Vlorë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Nevojitet lehtësim i procedurave për përfitimin e bonuseve sociale nga bashkia Vlorë, si dhe mbështetja me këtë shërbim për gratë e dhunuara, duke qenë se për vitin 2018, asnjë prej grave nuk ka përfituar bonus social nga bashkia.
- Rekomandohen trajnime të përbashkëta të anëtarëve të Mekanizmit të Referimit Vlorë, në mënyrë që të përfitohet Identifikimi i hershëm; Te kuptuarit e njëjtë të rrishtit dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

- Bashkia Vlorë duhet të parashikojë një zë të veçantë në buxhetin e bashkisë për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit për për ta mbështetur me materiale promovuese si dhe duhe të alokojë buxhet dedikuar mirëfunksionimit dhe veprimtarisë së MKR.
- Duhet vendosur në mënyrë emergjente marrëdhënia me Zyrën e Përmbartimit dhe me Shërbimin e Provës, institucione këto me të cilat bashkëpunimi mungon.
- Bashkia Vlorë vazhdon të paraqesë të njëjtat nevoja emergjente për manaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës: mungesa e banesave sociale për strehim dhe akomodim të rasteve viktime të dhunës; mungesa e një mjeti transporti në manaxhimin e bashkisë për transportin fizik të viktimave të dhunës në qendra të specializuara. Për këto arsye, rekomandohet adresimi dhe gjetja e zgjidhjeve imediate.
- Ka një sërë shërbimesh që mungojnë në bashkinë Vlorë, por një ndër më kryesorët mbetet rehabilitimi i dhunuesve përmes programeve të specializuara.
- Rekomandohet ngritja e linjës së këshillimit/qendër rehabilitimi për dhunuesit burra.
- Një qendër e specializuar shërbimesh për viktimat e dhunës në familje me probleme të shëndetit mendor që paraqesin nevoja urgjente për strehim është një tjetër rekomandim për bashkinë Vlorë.